

K O M E N T A R

LIGJ

Nr. 25/2018

PËR KONTABILITETIN DHE PASQYRAT FINANCIARE

Ligji 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme për hartimin dhe përbërësit e pasqyrave financiare, përcaktimin e standardeve kontabël të zbatueshme, si dhe mbajtjen e kontabilitetit. Ky ligj zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike fitimprurëse (pavarësisht formës së tyre juridike – person fizik, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar apo shoqëri aksionare) si dhe nga të gjitha njësitë ekonomike jofitimprurëse (me përjashtim të rasteve kur pasqyrat financiare dhe kontabiliteti i tyre janë subjekt i ligjeve ose i rregullimeve të veçanta si p.sh, rasti i organizatave të huaja që operojnë në Shqipëri të cilat sipas marrëveshjeve të Qeverisë shqiptare me vendet e tyre të origjinës i ka përjashtuar ato nga detyrimi për të hartuar dhe depozituar pasqyra financiare).

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 3 Përkufizime

Termi ‘**njësi ekonomike**’ përfshin personat juridikë dhe fizikë, publikë dhe privatë, me dhe pa qëllime fitimprurëse, që kryejnë veprimtari dhe kanë seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë. Në njësitë ekonomike publike përfshihen të gjitha shoqëritë me aksionar të vetëm shtetin si p.sh, ndërmarrjet publike të shërbimeve utilitare (furnizimi me ujë, energji, etj). Ky ligj nuk zbatohet nga njësitë ekonomike të Qeverisjes së Përgjithshme që do të thotë tërësia e njërive të qeverisjes qendrore, vendore dhe të fondeve speciale (ref. ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar).

Termi “**Njësi ekonomike jofitimprurëse**” është i njëjtë me kuptimin dhe përkufizimin e OJF-ve dhënë në Ligjin 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” si dhe përcaktimit të dhënë në SKK për OJF-të. Në këtë Standard jepet një listë jo shteruese e njësive ekonomike që konsiderohen jofitimprurëse si p.sh, fondacionet, shoqatat, qendrat, partitë politike, institucionet fetare, sindikatat dhe çdo organizatë tjetër e papërmendur në këtë Standard, por që ka statusin e një organizate jofitimprurëse (krijuar për të kryer aktivitete të veçanta të një natyre bamirëse apo altruiste; nuk tatohet (për aq sa nuk kryen aktivitet ekonomik fitimprurës); e ka të ndaluar t’i shpërndajnë tepricat nga aktivitetet tek themeluesit dhe/ose anëtarët; dhe nuk zotërohet ose kontrollohet nga Qeveria), përveç atyre OJF-ve apo disa prej veprimtarive të tyre, të cilat me ligj të veçantë, përjashtohen nga detyrimi për të ndërtuar dhe raportuar pasqyrat e tyre financiare. Nuk janë organizata jofitimprurëse, në kuptim të këtij ligji dhe SKK për OJF-të, agjencitë e ndryshme qeveritare apo entet rregullatore të cilat edhe pse nuk ushtrojnë aktivitet me qëllim fitimprurës gjithësesi kontrollohen nga Qeveria. Si të tilla nuk gëzojnë statusin e OJF-ve.

Termi ‘**njësi ekonomike me interes publik**’ i referohet njësive ekonomike, publike apo private, të cilat për nga natyra, madhësia apo numri i të punësurve janë me interes për publikun. Përcaktimi i njësive ekonomike me interes publik është ai i dhënë në ligjin Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, neni 2, pika 23 si dhe në VKM nr. 17, datë 16.1.2019 “Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre”. Në këtë grup njësish ekonomike përfshihen:

1. të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë;
2. bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
3. shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar;
4. shoqëritë e tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave, në grupin e katërt të klasifikimit të mësipërm, konsiderohen NjEIP edhe ato njësi ekonomike, të cilat njëkohësisht plotësojnë:

- a) kriteret për t'u audituar; si dhe
- b) kriterin/et e natyrës / madhësisë / numrit të të punësuarve (i mjaftueshëm një kriter):
 - i. shoqëri ku shteti ka pjesëmarrje në kapital;
 - ii. shoqëri që kanë më shumë se 50% të të ardhurave nga fondet publike;
 - iii. shoqëri që operojnë si degë, shoqëria mëmë e të cilave është e listuar në bursë;
 - iv. shoqëri të cilat ofrojnë një të mirë publike në aktivitetin e tyre tregtar dhe janë subjekt i rregullatorëve të fushës përkatëse. Lista e rregullatorëve miratohet dhe përditësohet brenda muajit Tetor të çdo viti nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.
 - v. shoqëri që, për dy vite rradhazi, vlerën e totalit të të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël e kanë të barabartë ose më të madhe se 1,500,000,000 Lekë (një miliard e pesëqind milion lekë);
 - vi. shoqëri që, për dy vite rradhazi, vlerën e totalit të aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar, në mbyllje të periudhës kontabël, e kanë të barabartë ose më të madhe se 750,000,000 Lekë (shtatëqind e pesëdhjetë milion lekë)
 - vii. shoqëri që, në fund të periudhës kontabël, kanë më shumë se 250 punonjës;
 - viii. shoqëri që, për gjithë periudhën kontabël, kanë një numër mesatar punonjësish prej më shumë se 250.

Termi “**interes në pjesëmarrje**” nënkupton të drejtat në kapitalin e njësive ekonomike të tjera. Por zotërimi i një pjese të kapitalit të një njësie ekonomike tjetër presumohet se përbën interes në pjesëmarrje kur e kalon pragun prej **20** për qind. Zotërimi i një kuote më të vogël nënkupton ‘investime të tjera financiare’ në letra me vlerë, tituj kapitali.

Monedha funksionale është monedha e mjedisit ekonomik kryesor, në të cilin vepron njësia ekonomike. Me ligjin 25/2018, njësitë ekonomike janë të lejuara të mbajnë kontabilitetin në monedhën në të cilën zhvillohet pjesa më e madhe e aktivitetit të tyre ekonomik, pavarësisht se mund të jetë e ndryshme nga monedha e paraqitjes.

Person përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare – Njësia ekonomike mund ta mbajë kontabilitetin dhe të hartojë pasqyrat financiare brenda njësisë përmes stafit të saj teknik të punësuar sipas kontratës së punës ose mund ta sigurojë këtë shërbim jashtë njësisë.

Në rastin e parë, një individ që punon me kontratë pune pranë njësisë ekonomike për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare nuk ndalohej të jetë i dypunësuar. I vetmi kufizim në këtë rast është përcaktimi i dhënë në kodin e punës për orët e lejuara të punës gjatë javës.

Në rastin e dytë, njësia lidh një kontratë shërbimi për ofrimin e shërbimeve të kontabilitetit me një person fizik apo juridik, të licensuar për ofrimin e këtij shërbimi. Shërbimet e kontabilitetit mund të ofrohen nga persona fizik apo juridik të cilët janë licensuar si kontabilistë të miratuar / shoqëri kontabiliteti ose auditues ligjor / shoqëri auditimi. Dispozitat që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e KM dhe AL janë sanksionuar në Ligjin Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” i ndryshuar.

Neni 4 - Kategoritë e njësive ekonomike dhe grupeve

Në kuadër të transpozimit të Direktivës së kontabilitetit në BE, Dir 34/2013, në ligjin e ri të kontabilitetit janë parashikuar kufijtë e klasifikimit të njësive ekonomike për qëllime të raportimit financiar. Këto kufij janë të ndryshëm nga ato të përcaktuar për qëllime fiskale (legjislacioni fiskal për tatimin mbi të ardhurat) apo për qëllime makroekonomike (Ligji 10 042, datë 22.12.2008 *Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 8957, datë 17.10.2002 Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme*, i ndryshuar).

Në ligj parashikohet që për klasifikimin e njësive mjaftojnë dy nga tre kufijtë e përcaktuar, pra pesha e secilit është e barabartë. Kujtojmë se në klasifikimin e mëparshëm sipas ligjit 10042 “Mbi klasifikimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”, kufiri i numrit të punonjësve ishte njëri nga kriteret përcaktues ndërsa kriteri tjetër ishte kufiri i shifrës së afarizmit ose ai shifrës së aktivitetit. Gjithashtu, për të bërë klasifikimin e njësisë ekonomike, kufijtë e përcaktuar në këtë ligj duhet të respektohen për dy vite rradhazi. Për shembull, nëse njësia ekonomike në fund të periudhës raportuese 20X0 klasifikohet, referuar treguesve të xhiros, aktivitetit dhe të punësuarve, si njësi ekonomike e vogël por në vitet 20X1 dhe 20X2 plotëson kriteret për t’u klasifikuar si njësi ekonomike mikro, atëherë në vitet 20X1 dhe 20X2 vazhdon të hartojë pasqyra financiare me

SKK (1-14) ndërsa në vitin 20X3 do të mbajë kontabilitetin dhe do të hartojë pasqyrat financiare sipas SKK 15 “Për kontabilitetin dhe raportimin e mikronjësive”.

I njëjti parim zbatohet edhe në rastet e tjera, p.sh, një n jësi ekonomike që në vitet 20X0 deri 20X5 ka zbatuar SNRF-të dhe në vitet 20X6-20X7 plotëson kriteret për zbatimin e SKK-ve, sipas kërkesave të parashikuara në ligj do të vazhdojë të zbatojë SNRF-të edhe në vitet 20X6-20X7 për të kaluar në zbatimin e SKK-ve nga vitit 20X8 e në vijim. Kalimi nga SNRF-të tek SKK-të do të kërkojë shënime shpjeguese që shpjegojnë diferencat e krijuara nga kalimi tek SKK-të. Meqenëse nuk ka një standard kombëtar të posaçëm për aplikimin për herë të parë të SKK-ve, atëherë politikat kontabël të parashikuara nga SKK-të do të aplikohen në prospektivë.

Në ligjin e ri parashikohet edhe klasifikimi i grupeve ekonomike. Por në rastin e grupeve ka një specifikë në klasifikim. Nëse klasifikimi i grupit bëhet përpara kryerjes së eliminimeve të transaksioneve brenda grupit, atëherë kufijtë e parashikuar në këtë ligj duhen rritur me 20%. Nëse ka përfunduar eliminimi i transaksioneve brenda grupit (në kuadër të përgatitjes së pasqyrave të konsoliduara të grupit) atëherë kufijtë e klasifikimit janë ato të dhëna në nenin 4, pika 2, të ligjit të kontabilitetit.

Në ligj thuhet se kufijtë e klasifikimit të njësive ekonomike / grupeve do të ndryshojnë proporcionalisht çdo tre vjet deri sa në vitin 2028 të kenë arritur nivelet e përcaktuara në Direktivën 34/2013 të BE-së. Kjo do të thotë se njësia ekonomike / grupi duhet sërish të riklasifikohet në fillim të vitit 2022, 2025 dhe 2028. Në këto data nuk vlen rregulli i parashikuar në pikën 5, të nenit 4 të ligjit të kontabilitetit. Klasifikimi do të bëhet me informacionin e marrë respektivisht nga pasqyrat e vitit 2021, 2024 dhe 2027 për shifrën e afarizmit, të aktivitetit dhe numrin e punonjësve.

Neni 5 - Standardet kontabël që zbatohen për hartimin e pasqyrave financiare

Njësitë ekonomike, në masën më të madhe të tyre, zbatojnë SKK-të në hartimin e pasqyrave financiare. Standardet kombëtare të kontabilitetit janë të zbatueshme nga njësitë ekonomike mikro, të vogla dhe të mesme, me përjashtim të rasteve kur janë njësi ekonomike me interes publik që veprojnë në sektorë të caktuar, të parashikuar në këtë ligj.

Zbatojnë SNRF-të njësitë ekonomike me interes publik dhe rregullatorët e disa prej njësive ekonomike me interes publik *(ato që veprojnë në fushën e kreditimit si p.sh Banka e Shqipërisë*

dhe në fushën e sigurimeve si p.sh, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare). Njësitë ekonomike të mëdha zbatojnë SNRF-të pasi konsiderohen njësi ekonomike me interes publik.

Përfshihen nga detyrimi për të raportuar me SNRF të gjitha ato njësi ekonomike të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave si të rëndësishme për interesin e publikut (NJEIP) për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, POR që nuk tejkalojnë **të paktën dy nga** kriteret e përcaktuara në nenin 4, pika 1.3 të ligjit të kontabilitetit:

- a) aktivi, 750 milionë lekë;
- b) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), 1 500 milionë lekë;
- c) numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 250.

Nuk bëjnë pjesë në grupin e njësive të përjashtuara nga detyrimi për zbatimin e SNRF-ve, pavarësisht madhësisë së tyre apo numrit të të punësuarve:

- a) të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë;
- b) bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
- c) shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar;

Të gjitha njësitë ekonomike, përveç atyre që me ligj detyrohen të zbatojnë SNRF-të, mund t'i zbatojnë ato në mënyrë të vullnetshme në hartimin e pasqyrave financiare. Pra ligji lejon por nuk kërkon zbatimin e SNRF-ve edhe nga njësitë që kanë detyrimin të zbatojnë SKK-të.

KREU II

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME MBI DOKUMENTET KONTABËL DHE PASQYRAT FINANCIARE

Neni 6 - Mbajtja e kontabilitetit

Njësitë ekonomike, në varësi të standardeve që zbatojnë për hartimin e pasqyrave financiare, i referohen BSNK-së apo KKK-së lidhur me parimet, metodat dhe udhëzimet kontabël në zbatim

të tyre. KKK-ja nuk është e autorizuar të bëjë interpretime të SNRF-ve. Njësitë ekonomike i drejtohen KKK-së për interpretime të ngjarjeve apo transaksioneve në kuptim vetëm të SKK-ve.

Neni 8 - Ruajtja e dokumenteve kontabël

Ligji parashikon që dokumentet kontabël duhet të ruhen për një periudhë 10 vjeçare. Llogaritja e këtij afati bëhet duke filluar nga periudha që fillon pas datës së mbylljes së atyre pasqyrave ku janë përfshirë dokumentet kontabël. Pasqyrat financiare të njësisë ekonomike ruhen në selinë ku ajo zhvillon aktivitetin ose në selinë qendrore të saj, në rast se ndonjë rregullim tjetër ligjor nuk përcakton ndryshe.

Pasqyrat financiare të grupeve ruhen në selinë e njësisë ekonomike mëmë. Termi “seli” i referohet përcaktimit të dhënë në legjislacionin fiskal. Meqenëse periudha e ruajtjes së dokumente fillon në vitin pasardhës së datës së dokumentit, atëherë nuk ka asnjë konflikt me praktikën e bizneseve që gjatë vitit mund t’i mbajnë dokumente në zyrat e personit përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare, kur ky shërbim sigurohet nga jashtë njësisë ekonomike.

Neni 9 - Periudha raportuese

Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj, fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat. Në disa raste kohëzgjatja mund të jetë më e gjatë ose më e shkurtër se 12 muaj, por jo më pak se tre muaj dhe jo më shumë se 15 muaj. Në rast se kohëzgjatja e aktivitetit është më e shkurtër se tre muaj, atëherë informacioni i kësaj periudhe i bashkëngjitet periudhës pasardhëse ose paraardhëse, sipas rastit.

Psh, një njësi ekonomike regjistrohet si subjekt në QKB në fillim të tremujorit të fundit të vitit 20X0. Për këtë periudhë raportuese 3 mujore, njësia nuk përgatit pasqyra financiare 20X0 por informacionin e kësaj periudhe e bashkon me informacionin financiar të vitit 20X1 duke paraqitur një pasqyrë të përbashkët. Informacioni në pasqyrën 20X1 i takon një afati 15 mujor. Për analogji, nëse njësia ekonomike do të mbyllë aktivitetin e saj në tremujorin e parë të vitit 20X1, atëherë informacioni financiar i kësaj periudhe tremujore nuk paraqitet veçmas por i bashkohet informacionit të vitit të mëparshëm për t’u paraqitur në pasqyrat financiare 20X0.

Pavarësisht se rregullimi fiskal ka përcaktuar afatin 12 muaj, janar – dhjetor, si periudhë të raportimit fiskal, kërkesa për një periudhë më të gjatë apo më të shkurtër të raportimit financiar

nuk bie ndesh me të parën. Për qëllime të llogaritjes së fitimit fiskal, njësia ekonomike bën llogaritjet dhe rregullimet përkatëse, për të kaluar nga fitimi kontabël tek fitimi fiskal.

Neni 10 - Gjuha dhe njësia monetare e regjistrave kontabël dhe pasqyrave financiare

Regjistrat kontabël mbahen në gjuhën shqipe dhe vlerat shprehen në monedhën funksionale, pavarësisht faktit nëse monedha funksionale është e njëjtë apo e ndryshme me monedhën e paraqitjes. Ndërsa pasqyrat financiare paraqiten në gjuhën shqipe dhe vlerat shprehen vetëm në monedhën e paraqitjes që është njësia monetare kombëtare (lekë). Në rast se njësia ka marrëdhënie biznesi apo përfiton donacione nga njësi ekonomike të huaja, që do të thotë se ka dokumente në gjuhë të huaj që evidentojnë marrëdhëniet e saj me njësi ekonomike të huaja, atëherë këto dokumente duhet të përkthehen në gjuhën shqipe.

Regjistrat kontabël, pra regjistrimi i transaksioneve në këto regjistra bëhet në një rën prej dy mënyrave si më poshtë:

- në njësi monetare kombëtare ose në njësi monetare të huaja, kur kjo e fundit është monedha funksionale; në rast se regjistrat mbahen në monedhën të huaj sepse kjo e fundit është monedha funksionale, atëherë në fund të periudhës raportuese informacioni përkthehet në monedhën e paraqitjes, njësi monetare kombëtare, duke respektuar kërkesat e standardeve të kontabilitetit (*SKKtë - SKK 12, pg 30 apo SNRFtë - SNK 21, pg 39*).

Sipas SKK-ve / SNRF-ve, rezultatet dhe pozicioni financiar i një njësie ekonomike, monedha funksionale e të cilës nuk është monedhë e një ekonomie hiperinflacioniste, do të përkthehen¹ në një monedhë paraqitjeje të ndryshme duke ndjekur procedurat e mëposhtme:

(a) aktivet dhe detyrimet të çdo pasqyre të pozicionit financiar të paraqitur (d.m.th. duke përfshirë shumat krahasuese) do të përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes në datën e kësaj pasqyre të pozicionit financiar;

(b) të ardhurat dhe shpenzimet e çdo pasqyre që paraqet rezultatin dhe të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (d.m.th. duke përfshirë shumat krahasuese) do të përkthehen me kursin e këmbimit të datës të kryerjes së transaksionit; dhe

(c) të gjitha diferencat që lindin nga këmbimi do të njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

¹ Shih shembullin në Shtojcën 1

- në njësi monetare të huaja, duke i konvertuar ato në njësi monetare kombëtare apo në monedhë funksionale, nëse monedha funksionale është e ndryshme nga njësia monetare kombëtare dhe monedha e huaj; në këtë rast njësia ekonomike çdo transaksion në monedhë të huaj e regjistron në monedhën kombëtare apo në monedhën funksionale duke aplikuar kursin e menjëhershëm të këmbimit mes monedhës kombëtare/funksionale dhe monedhës së huaj në datën e këmbimit. Në zbatimin korrekt të kësaj kërkesë të ligjit, njësia ekonomike mban parasysh sa parashikohet në standardet e kontabilitetit (SKK 12, pg 11 apo SNK 21, pg 21) për raportimin në monedhë funksionale të transaksioneve në monedhë të huaj.

Pasqyrat financiare mund të paraqiten në shifra të rrumbullakosura, nëse nuk shkaktohet humbje e të dhënave, që kanë ndikim te përdoruesit e këtyre pasqyrave.

KREU III

PËRBËRËSIT E PASQYRAVE FINANCIARE

Neni 12 - Pasqyrat financiare të konsoliduara

Në pikën 3 të këtij neni parashikohet që njësia ekonomike mëmë dhe të gjitha njësitë e kontrolluara prej saj duhen përfshirë në konsolidim, pavarësisht se ku operojnë dhe ku i kanë selitë njësitë e kontrolluara. Gjithashtu, në SKK 9, pg 33-43 (viti 2015) si dhe në SNRF 10, pg 33, parimi është i njëjtë, pra nuk parashikohen raste në Standardet kontabël kur një njësi ekonomike e kontrolluar të mund të përjashtohet nga konsolidimi në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike mëmë. Ndërsa në Direktivën e BE për kontabilitetin, Dir 34/2013, në nenin 23.9 (c) të saj parashikohet përjashtimi i njësisë mëmë nga detyrimi për të konsoliduar bijat që operojnë në juridiksione me kufizime të forta afatgjata lidhur me të drejtat mbi aktivet apo menaxhimin e saj. Kjo kërkesë e Direktivës mbahet parasysh në ndryshimin e bërë në SKK 9, miratuar me Urdhër nr 28, datë 30.01.2019, të Ministrisë përgjegjëse për financat.

Neni 13 Përbërësit e pasqyrave financiare

Njësitë ekonomike të klasifikuara ‘të vogla’ hartojnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Për plotësimin e këtyre pasqyrave, njësitë ekonomike të vogla i referohen SKK 2 *Paraqitja e*

pasqyrave financiare. Në rast se njësia ekonomike, e klasifikuar njësi e vogël, është njësi ekonomike me interes publik që ka detyrimin të zbatojë SNRF-të apo zgjedh në mënyrë të vullnetshme të zbatojë SNRF-të, atëherë për hartimin e pasqyrave financiare i referohet këtyre standardeve.

Njësitë ekonomike të klasifikuara ‘të mesme’, ‘të mëdha’ si dhe ‘me interes publik’, përveç pasqyrave që kërkohen në pikën 1 të këtij neni, hartojnë edhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapitalet e veta. Në varësi të standardeve që zbatojnë (kombëtare apo ndërkombëtare) bëhet hartimi dhe paraqitja e pasqyrave financiare vjetore.

Njësitë ekonomike të klasifikuara “mikro”, hartojnë pasqyrën financiare të pozicionit financiar (të shkurtuar) dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve (të shkurtuar) në përputhje me sa kërkohet në SKK 15 “Për kontabilitetin dhe raportimin e mikronjësive”, i ndryshuar (2019). Këto pasqyra shoqërohen edhe me shënimet shpjeguese përkatëse. Referuar SKK 15, paragrafi 5, mikronjësitë me qarkullim vjetor deri në 5 milionë lekë përjashtohen nga detyrimi për hartimin e pasqyrave financiare vjetore sipas kërkesave të këtij standardi. Këto mikronjësi respektojnë rregullimet e legjislacionit fiskal në fuqi për deklaratimet e tyre. Në rastet kur një njësi ekonomike, për nga kriteret, klasifikohet mikronjësi por është njësi ekonomike financiare tip “holding”, ajo nuk zbaton SKK 15 por rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për institucionet financiare jobankare.

Njësitë ekonomike jofitimprurëse (OJF), të përkufizuara në këtë ligj si njësi ekonomike që nuk kanë qëllim të realizojnë nga aktiviteti i tyre fitime që u ndahen investuesve në aktivet neto të tyre, hartojnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e aktiviteteve, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese të këtyre pasqyrave. Referuar SKK për OJF, paragrafi 26, ato OJF që kanë shifrën e aktivitetit ose shifrën e të ardhurave më të madhe se 5 milion lekë, zbatojnë kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuar dhe ndërtojnë të gjitha pasqyrat financiare sipas paragrafit të këtij Standardi ndërsa OJF-të të cilat nuk plotësojnë këtë kriter zbatojnë kontabilitetin mbi baza monetare dhe ndërtojnë vetëm pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare të shoqëruar me shënimet shpjeguese lidhur me llojin e aktiviteteve apo shërbimeve që ofrojnë.

Neni 14 Rregullime të veçanta për pasqyrën e pozicionit financiar

Pika 1 - Sipas SKK-ve shpenzimet e zhvillimit, nëse nuk janë pjesë e kostos së një aktivi tjetër që plotëson kriteret e njohjes, trajtohen si shpenzime të periudhës kur ato ndodhin. Ndërsa sipas SNRF-ve, këto shpenzime nëse plotësojnë kriteret e përcaktuara në paragrafët 54-62 të SNK 38, trajtohen si zë i aktiveve. Kur shpenzimet e zhvillimit përfshihen tek aktivet, njësia ekonomike, kur vendos për shpërndarjen e fitimit, mban parasysh faktin nëse ky element i aktivitetit është amortizuar ose jo plotësisht. Nëse ky element i aktivitetit nuk është amortizuar plotësisht, shpërndarja e fitimit bëhet deri në masën ku pjesa e mbetur e fitimit të pashpërndarë plus rezervat të jetë i barabartë me koston e paamortizuar të këtij aktivi (Dir 34/2013, neni 12, pika 11, subparagrafi i tretë).

Shembull

Njësia ekonomike A ka njohur në korrik të vitit 20X1, një aktiv jomaterial (kostot e zhvillimit), në vlerën 1.8 milion lekë, në përputhje me kërkesat e SNK 38. Në pasqyrat financiare për periudhën 20X1 nuk ka rezerva dhe fitim të pashpërndarë të periudhave të mëparshme. Njësia ekonomike ka vendosur ta amortizojë aktivin përgjatë afatit 10 vjeçar në mënyrë lineare. Në vitet 20X1 – 20X5 fitimet e njësisë ekonomike kanë qenë respektivisht 4, 5, 3, 3 dhe 2 milion lekë. Norma tatimore 15%. Politika e dividendëve ka qenë për shpërndarjen e plotë të fitimit. Si janë llogaritur shpërndarjet dhe rezervat për vitet 20X1 – 20X5?

Shënim! Për këtë shembull do të supozohet se fitimi kontabël dhe ai fiskal janë të barabartë.

Llogaritja e amortizimit të aktivitetit jomaterial (kostot e zhvillimit) për vitet 20X1 – 20X5

Nr	Vlera në fillim të periudhës	Amortizimi	Vlera në fund të periudhës
1	1,800,000	90,000	1,710,000
2	1,710,000	180,000	1,530,000
3	1,530,000	180,000	1,350,000
4	1,350,000	180,000	1,170,000
5	1,170,000	180,000	990,000

Shpërndarjet dhe rezervat për vitet 20X1 – 20X5

Nr	Fitimi para tatimit	Tatimi	Fitimi neto për t'u shpërndarë	Kostot e zhvillimit (AAJM) të paamortizuara	Dividendi	Llogaritja e fitimit për t'u shpërndarë (dividendi i paguar)
0	1	2=1*15%	3=1-2	4	5	6
1	4,000,000	600,000	3,400,000	1,710,000	1,690,000	1,690,000 = 3,400,000 -1,710,000
2	5,000,000	750,000	4,250,000	1,530,000	4,430,000	4,430,000 = 1,710,000 + 4,250,000 – 1,530,000
3	3,000,000	450,000	2,550,000	1,350,000	2,730,000	2,730,000 = 1,530,000 + 2,550,000 – 1,350,000
4	3,000,000	450,000	2,550,000	1,170,000	2,730,000	2,730,000 = 1,350,000 + 2,550,000 – 1,170,000
5	2,000,000	300,000	1,700,000	990,000	1,880,000	1,880,000 = 1,170,000 + 1,700,000 – 900,000

Fitimi neto i fituar në 5 vite: 14,145,000 (3,400,000 + 4,250,000 + 2,550,000 + 2,550,000 + 1,700,000)

Dividendi i paguar (kumulativ) në 5 vite: 13,460,000 (1,690,000 + 4,430,000 + 2,730,000 + 2,730,000 + 1,880,000)

Diferenca mes fitimit neto dhe dividendëve të paguar, në periudhën 5 vjeçare: 990,000 (14,450,000 – 13,460,000). Kjo diferencë është e barabartë me vlerën e mbetur të kostove të zhvillimit (AAJM) në fund të vitit të pestë (990,000 lekë).

Pika 2 - Në rastet kur njësi ekonomike ka **investime në pjesëmarrje** dhe përdor metodën e kapitalit neto për njohjen dhe matjen e tyre, atëherë ka të ngjarë që të ardhurat e njohura në pasqyrën e performancës nga pjesëmarrja të jenë më të mëdha se dividendi i arkëtuar ose për t'u arkëtuar nga pjesëmarrja. Në rastet kur të ardhurat e njohura si interesa në pjesëmarrje, tejkalojnë

shumën e dividendit të arkëtuar apo për t'u arkëtuar, diferenca vendoset në rezerva, pra nuk i'u shpërndahet aksionarëve.

Shembull

Njësi ekonomike A ka investime në pjesëmarrje në kapitalet e njësisë ekonomike B, në masën 35%. Njësia A për matjen e investimeve në pjesëmarrje ka zgjedhur metodën e kapitalit neto. Për vitin 20X1 njësia ekonomike B ka raportuar një fitim në vlerën 200,000 lekë. Njësia ekonomike A bën veprimin rregullues në kontabilitetin e vet duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve një *të ardhur nga investimet në pjesëmarrje* në masën 35% të fitimit të raportuar nga njësia ekonomike B, pra në vlerën 70,000 lekë. Dividendi i arkëtuar nga njësia ekonomike A për investimet në pjesëmarrje tek njësia ekonomike B është në vlerën 40,000 lekë, pra në një vlerë më të vogël se e ardhura që ka njohur kjo njësi si fitim nga investimet në pjesëmarrje. Diferenca prej 30,000 lekë, do të kalojë në rezerva. Pra në PASH do të raportohet një e ardhur nga investimi në pjesëmarrje në masën 40,000 lekë dhe pjesa tjetër, në vlerën 30,000 lekë do të raportohet tek të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Shembulli tjetër për të udhëzuar mbi zbatimin e pikës 2 të nenit 14 është dhënë në shtojcën 2 të këtij komentari.

Neni 15 Inventari i aktiveve dhe detyrimeve

Njësitë ekonomike, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese (kryesisht në fund të periudhës raportuese) kontrollojnë ekzistencën dhe vlerën e aktiveve, detyrimeve dhe kapitaleve të veta. Inventarizimi i aktiveve me përmbajtje fizike bëhet jo vetëm përmes numërimit të tyre por dhe duke i krahasuar gjendjet fizike me ato kontabël, të cilat janë njohur me dokumente përkatëse kontabël. Ndërsa inventarizimi i aktiveve me përmbajtje jofizike si dhe i detyrimeve bëhet përmes verifikimit të ekzistencës së tyre me konfirmime të palëve të përfshira ose mjeteve të tjera të gjykuara të përshtatshme nga drejtimi i njësisë ekonomike. Vlerësimi i aktiveve, detyrimeve dhe zërave të kapitalit bëhet sipas kërkesave të standardeve kombëtare apo ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar. Për të standardizuar procedurat e kontrollit të ekzistencës dhe vlerësimit të aktiveve, detyrimeve dhe zërave të kapitalit, KKK-ja harton rregulloren e inventarizimit.

Përgjegjësi **për ndjekjen e procedurave të inventarizimit** mban organi i drejtimit, pjesë e të cilit janë të gjithë drejtuesit e departamenteve, përfshirë drejtuesin e departamentit të kontabilitetit. Në njësitë ekonomike që shërbimet e kontabilitetit merren nga persona fizik apo juridik të licensuar për të ofruar këtë shërbim sipas kontratës së shërbimit, përgjegjësitë parashikohen në kontratën mes palëve.

Shënim!

- 1. Organi ekzekutiv është organi i ngarkuar me menaxhimin/ administrimin e shoqërisë, në varësi të formës ligjore të shoqërisë;*
- 2. Organet e drejtimit, nënkuptojnë organin i cili ka përgjegjësinë për menaxhimin/ administrimin e shoqërisë ose ka kompetenca vendimmarrëse për të mirën e shoqërisë, në varësi të formës ligjore apo organizimit të shoqërisë. Shpesh herë organi i drejtimit mund të përputhet me organin ekzekutiv;*
- 3. Organi mbikqyrës, është organi të cilit i është ngarkuar mbikqyrja e veprimtarisë së shoqërisë.*

Neni 16 Shënimet shpjeguese

Në pasqyrat financiare të publikuara sipas SKK 2 si dhe në kërkesat e parashikuara tek standardet ndërkombëtare për paraqitjen e pasqyrave financiare, zërat e pasqyrave paraqiten sipas një renditje të caktuar shoqëruar me numra të kategorive kryesore dhe nënkategoritë e tyre. Sipas kësaj renditje të zërave të pasqyrave financiare bëhet edhe renditja e shënimeve shpjeguese të këtyre zërave.

Të gjitha njësitë ekonomike, pavarësisht klasifikimit të tyre, duhet të japin në shënimet shpjeguese numrin mesatar të punonjësve gjatë periudhës raportuese. Për njësitë ekonomike fitimprurëse dhënia e këtij informacioni shërben ndër të tjera edhe për çështjen e monitorimit të pasqyrave financiare, sepse numri i punonjësve është një ndër tre kriteret për klasifikimin e njësive. Klasifikimi i njësisë përcakton standardet e zbatueshme të kontabilitetit dhe raportimit financiar, përjashtuar rastin kur njësia ekonomike është njësi me interes publik.

Njësitë ekonomike fitimprurëse, përjashtuar mikrot dhe të voglat (nëse këto të fundit nuk janë njësi ekonomike me interes publik), duhet të paraqesin në shënimet shpjeguese të pasqyrave, përveç sa kërkohet në standardet e kontabilitetit dhe raportimit financiar edhe informacionet si më poshtë:

1) nëse dhënia e këtij informacioni nuk do të bënte që të identifikoheshin gjendja financiare e një anëtarit konkret të këtyre organeve, njësisë ekonomike paraqet;

- a) shumën e pagave që u jepet për periudhën raportuese anëtarëve të organeve ekzekutive, drejtuese dhe mbikëqyrëse, duke treguar edhe shumën gjithsej të paguar për secilin prej organeve;
- b) çdo angazhim që lind ose merret përsipër nga njësisë ekonomike në lidhje me pensionet e ish-anëtarëve të këtyre organeve;

2) lidhur me punëmarrësit, njësisë ekonomike e detajon këtë informacion në:

- a) numrin mesatar të punëmarrësve, të cilin e paraqet të zërthyer sipas kategorive të punëmarrësve;
- b) kostot e personelit gjatë periudhës raportuese, të cilat i paraqet të zërthyer sipas pagave, kostove të sigurimeve & shoqërore dhe kostove të pensionit (për rastet kur PASH është ndërtuar sipas funksionit pra kostot e personelit nuk janë paraqitur më vete në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën raportuese).

3) emrin dhe selinë për secilën prej njësive ekonomike, në të cilat njësisë ekonomike, *ose vetë, ose përmes një personi që vepron në emër të tij, por për llogari të njësive ekonomike*, zotëron një interes në pjesëmarrje, duke treguar përqindjen e kapitalit të zotëruar, shumën e kapitalit dhe rezervave dhe fitimin ose humbjen për periudhën më të fundit raportuese të njësive ekonomike në fjalë për të cilën janë miratuar pasqyra financiare. Zotërimi i një pjese të kapitalit të një njësive ekonomike tjetër prezumohet se përbën interes në pjesëmarrje kur e kalon pragun prej 20 përqind.

Sa më sipër, nuk aplikohet nga njësisë ekonomike mëmë në rastet kur:

i) njësisë ekonomike, në të cilën njësisë ekonomike mëmë zotëron interes në pjesëmarrje, përfshihet në pasqyrat financiare të konsoliduara, të përpiluara nga njësisë ekonomike mëmë ose në pasqyrat financiare të konsoliduara të një grupi më të madh njësish ekonomike;

ii) ky interes në pjesëmarrje është trajtuar nga njësisë ekonomike mëmë në pasqyrat financiare vjetore të saj;

ç) ekzistencën e ndonjë certifikate pjesëmarrjeje, borxhi të konvertueshëm, të drejte blerjeje aksionesh, opsionesh ose letrash me vlerë apo të drejtash të ngjashme, duke treguar numrin e tyre dhe të drejtat që japin ato;

d) emrin, selinë dhe formën juridike të secilës prej njësive ekonomike, tek të cilat njësia ekonomike është ortake me përgjegjësi të pakufizuar;

dh) emrin dhe selinë e njësisë ekonomike që përpilon pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit më të madh të njësive ekonomike, tek i cili njësia bën pjesë si njësi e kontrolluar;

e) emrin dhe selinë e njësisë ekonomike që përpilon pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit më të vogël të njësive ekonomike, tek i cili njësia ekonomike bën pjesë si njësi e kontrolluar, e cila është e përfshirë, gjithashtu, në grupin e njësive ekonomike të përmendura në shkronjën “dh”, të kësaj pike;

ë) vendin ku mund të merren kopje të pasqyrave financiare të konsoliduara, të përmendura në shkronjat “dh” dhe “e”, të kësaj pike, me kusht që të jenë të disponueshme.

Njësitë ekonomike të mesme, të mëdha dhe ato me interes publik, përtej kërkesave të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni apo në standardet kontabël të aplikueshme, në shënimet shpjeguese duhet të paraqesin tarifatat gjithsej për periudhën raportuese, të kërkuara nga secili auditues ligjor apo firmë auditimi lidhur me auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore dhe tarifatat gjithsej të kërkuara nga secili auditues ligjor ose firmë auditimi për shërbime të dhënies së sigurisë, për shërbime këshillimore tatimore dhe për shërbime të tjera joauditimi.

Neni 17 Raporti i ecurisë së veprimtarisë

Detyrimi për përgatitjen e raportit të ecurisë dhe raporteve të tjera në plotësim të tij paraqitet skematikisht si më poshtë:

	Raporti i ecurisë së veprimtarisë	Raporti jofinanciar	Raporti i drejtimit të brendshëm
Njësitë ekonomike me interes publik	√	√ (mbi 500 të punësuar)	√ (përfshijë të voglat dhe të mesmet)
Njësitë ekonomike të mëdha	√	√ (mbi 500 të punësuar)	√
Njësitë ekonomike të mesme	√		
Njësitë ekonomike të vogla	- (me kushtin që të japin në shënimet shpjeguese info për blerjen e aksioneve të veta)	-	-
Mikronjësitë	-	-	-
Njësitë ekonomike jofitimprurëse	√	-	-

3. Përfshihen nga detyrimi për përgatitjen e raportit të ecurisë së veprimtarisë:

a) mikronjësitë;

b) njësitë e vogla ekonomike, me kushtin që të japin në shënimet shpjeguese të dhënat mbi blerjen e aksioneve të veta;

c) njësitë ekonomike jofitimprurëse, për të cilat shifra e aktivitetit dhe e të ardhurave në pasqyrat financiare nuk tejkalojnë vlerën 30 milionë lekë.

Neni 21 - Raportimi i pagesave që u bëhen institucioneve shtetërore

Në këtë nen parashikohet që kanë detyrimin të hartojnë dhe të publikojnë një raport për pagesat që u bëhen institucioneve shtetërore në mënyrë vjetore:

1. të gjitha njësitë ekonomike të mëdha; dhe

2. ato njësi ekonomike me interes publik, që janë aktive në industrinë nxjerrëse ose shfrytëzimin për lëndë drusore të pyjeve.

Ky raport do të dorëzohet së bashku me raportet e tjera të kërkuara nga dispozitat e këtij ligji. Njësia ekonomike me interes publik, aktive në industrinë nxjerrëse ose shfrytëzimin për lëndë drusore të pyjeve, trajtohet si njësi ekonomike e madhe, pavarësisht nga të ardhurat, aktivi ose numri mesatar i punëmarrësve gjatë periudhës raportuese.

Raporti duhet të paraqesë, gjithsej dhe në mënyrë të detajuar, për secilën lloj pagese të bërë ndaj institucioneve shtetërore, si parashikohet në pikën 4.b të nenit 21.

Neni 22 - Depozitimi dhe publikimi i pasqyrave financiare

Të gjitha njësitë ekonomike fitimprurëse, dorëzojnë në QKB, sipas rregullimeve në fuqi, pasqyrat e tyre financiare dhe raportet e tjera (sipas rasteve të parashikuara në ligj), jo më vonë se data 31 korrik e vitit pasardhës të pasqyrave financiare. Njësitë ekonomike të mesme, të mëdha me ato interes publik, kanë detyrimin që brenda 7 mujorit të viti pasardhës të pasqyrave, t'i publikojnë pasqyrat financiare dhe raportet që i shoqërojnë ato (sipas rasteve të parashikuara në ligj) edhe në faqet e tyre zyrtare të internetit.

Njësitë ekonomike mëmë, dorëzojnë në QKB dhe publikojnë në faqet zyrtare të internetit, edhe pasqyrat financiare të konsoliduara shoqëruar me raportet e konsoliduara sipas neneve 17, 18 dhe 19 të këtij ligji.

Njësitë ekonomike jofitimprurëse (OJF-të) dorëzojnë pasqyrat e tyre financiare në organet e tatim taksave brenda afateve të parashikuara në Ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Në rastet kur shifra e aktivitetit dhe e të ardhurave në pasqyrat financiare tejkalon vlerën 30 milionë lekë, OJF-të duhet t'i publikojnë pasqyrat e tyre financiare në faqen e tyre zyrtare të internetit jo më vonë se data 31 korrik e vitit pasardhës të pasqyrave financiare. OJF-të publikojnë në faqen e internetit, bashkë me pasqyrat financiare, raportin e performancës, formati i të cilit hartohet nga KKK.

Shtojcë 1

SHEMBULL: PËRKTHIMI I PASQYRAVE FINANCIARE NË MONEDHËN E PARAQITJES

Njësia ekonomike ABC u krijua në 1 janar të vitit 20X0. Monedha e saj funksionale është Euro. Meqenëse pronarët e saj duan të rrisin huanë bankare, nga një bankë e një vendi të huaj, ata përgatisin pasqyrat financiare në monedhën e vendi ku operon banka e huaj, në USD.

Pasqyrat financiare të njësisë ekonomike për vitet 20X0 dhe 20X1, të përgatitura në monedhën funksionale Euro janë si më poshtë:

Pasqyra e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 20X0

Përshkrimi	20X1	20X0
	<i>Euro</i>	<i>Euro</i>
Mjete monetare	494	200
Të drejta të arkëtueshme	300	200
Inventarë	150	250
Toka, ndërtesa, makineri e pajisje	840	870
<i>Totali i aktiveve</i>	<i>1,784</i>	<i>1,520</i>
Të pagueshme të shfrytëzimit	160	100
Detyrime ndaj shtetit	99	126
	<i>259</i>	<i>226</i>
Kapitali aksionar	1,000	1,000
Fitime të pashpërndara	525	294
	<i>1,525</i>	<i>1,294</i>
<i>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</i>	<i>1,784</i>	<i>1,520</i>

Pasqyra e të ardhura gjithëpërfshirëse më datë 31 dhjetor 20X0

Përshkrimi	20X1 <i>Euro</i>	20X0 <i>Euro</i>
Të ardhura	700	800
Kosto e mallrave të shitur	(200)	(250)
Fitimi bruto	500	550
Kostot e shpërndarjes	(90)	(80)
Shpenzimet administrative	(80)	(50)
<i>Fitimi para taksave</i>	330	420
Shpenzimet e tatim fitimit	(99)	(126)
Fitimi neto	231	294

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare më datë 31 dhjetor 20X0

Përshkrimi	20X1 <i>Euro</i>	20X0 <i>Euro</i>
<i>Flukset nga aktivitetet e shfrytëzimit</i>		
Arkëtuar nga klientët	600	600
Paguar furnitorëve dhe punonjësve	(180)	(500)
MM të gjeneruara nga aktiviteti i shfrytëzimit	420	100
Tatim fitimi i paguar	(126)	-
<i>Flukset neto nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	294	100
<i>Flukset nga aktivitetet e investimit</i>		
Shuma e paguar për blerjen e një AAM	-	(900)
<i>Nuk ka flukse nga aktivitetet e financimit</i>		
Rritja neto (Rënia) në MM dhe ekuivalentë të tyre	294	(800)
MM dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës	200	1,000
MM dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës	494	200

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit më datë 31 dhjetor 20X0

Përshkrimi	Kapitali aksionar	Fitimet e pashpërndara	Totali
	<i>Euro</i>	<i>Euro</i>	
Gjendja më 1 janar 20X0	1,000	-	1,000
Fitimi për 20X0		294	294
Gjendja më 31 dhjetor 20X0	1,000	294	1,294
Fitimi për 20X1		231	231
Gjendja më 31 dhjetor 20X1	1,000	525	1,525

Informacion shtesë:

Kurset e këmbimit spot kanë qenë si më poshtë:

Datë	Kursi
1 janar 20X0	1 Euro = 2 USD
31 dhjetor 20X0	1 Euro = 1.95 USD
31 dhjetor 20X1	1 Euro = 2.1 USD
Kursi mesatar 20X0	1 Euro = 2.11 USD
Kursi mesatar 20X1	1 Euro = 1.79 USD
Në datën e pagesës së Tatim fitimit	1 Euro = 2.05 USD
Në datën e blerjes dhe pagesës së AAM	1 Euro = 1.9 USD

Aktivitet neto në çelje, 1 janar 20X0 = 1,000 Euro

Për thjeshtësi, përdoret i njëjti kur mesatar për përkthimin e pasqyrave të të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe të flukseve të mjeteve monetare (përfshijtur tatim fitimit e paguar dhe shumën e paguar për blerjen e AAM-së)

Kërkohe:

Të përkthehen pasqyrat financiare 20X0 dhe 20X1 të njësisë ekonomike ABC nga monedha funksionale Euro në monedhën e paraqitjes USD.

Përgjigja –

Përkthimi në monedhën e paraqitjes të pasqyrës së pozicionit financiar

Përshkrimi i zërit	Euro	Kursi	USD	Euro	Kursi	USD
		20X1			20X0	
Aktive Afatgjata Materiale	840	2.1	1,764	870	1.95	1,696.5
Inventarë	150	2.1	315	250	1.95	487.5
Të arkëtueshme	300	2.1	630	200	1.95	390
Mjete monetare	494	2.1	1,037.4	200	1.95	390
Totali i aktiveve	1784		3,746.4	1520		2,964.0
Të pagueshme	160	2.1	336	100	1.95	195
Tatim taksa	99	2.1	207.9	126	1.95	245.7
<i>Totali i detyrimeve</i>	<i>259</i>		<i>543.9</i>	<i>226</i>		<i>440.7</i>
Kapitali aksionar	1,000	2	2,000	1,000	2	2,000
Rezerva për diferenca e konvertimit	n/a		169	n/a		(97)
Fitimi i pashpërndarë	525		1,033.8	294	2.11	620.3
<i>Totali i kapitalit</i>	<i>1,525</i>		<i>3,202.5</i>	<i>1,294</i>		<i>2,523.3</i>
Totali i detyrimeve dhe kapitalit	1,784		3,746.4	1,520		2,964

Përkthimi në monedhën e paraqitjes së pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse

Përshkrimi i zërit	Euro	Kursi	USD	Euro	Kursi	USD
		20X1			20X0	
Të ardhura	700	1.79	1,253	800	2.11	1,688
Kosto e shitjeve	(200)	1.79	(358)	(250)	2.11	(528)
Fitimi bruto	500		895	550		1,161
Kostot e shpërndarjes	(90)	1.79	(161.1)	(80)	2.11	(168.8)
Shpenzimet administrative	(80)	1.79	(143.2)	(50)	2.11	(105.5)
Fitimi para taksave	330		590.7	420		886.2
Shpenzimi i tatim fitimit	(99)		(177.2)	(126)		(265.9)
<i>Fitimi neto</i>	<i>231</i>		<i>413.5</i>	<i>294</i>		<i>620.3</i>
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</i>						
Diferenca këmbimi në përkthimin e monedhës	n/a		265.7	n/a		(97)
<i>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</i>	<i>231</i>		<i>679.2</i>	<i>294</i>		<i>523.3</i>

Llogaritja e diferencave nga ndryshimi i kursit të këmbimit të monedhave

Përshkrimi	20X1	20X0
	<i>Euro</i>	<i>Euro</i>
<i>Ripërktimi i vlerës së aktiveve neto nga kursi në çelje në kursin në mbyllje të pasqyrave</i>		
Aktivet neto në çelje të përkthyer me kursin e çeljes	2,523.3	2,000
Aktivet neto në çelje të përkthyer me kursin e mbylljes	2,717.4	1,950
Diferenca	(194.1)	50
<i>Ripërktimi i fitimit nga kursi mesatar në kursin e mbylljes</i>		
Fitimi i përkthyer me kursin mesatar	413.5	620.3
Fitimi i përkthyer me kursin e mbylljes	485.1	573.3
Diferenca	(71.6)	47
Totali i diferencave të ndryshimit të kurseve	(265.7)	97

Përkthimi në monedhën e paraqitjes së pasqyrës së flukseve të mjeteve monetare

Përshkrimi i zërit	Euro	Kursi	USD	Euro	Kursi	USD
		20X1			20X0	
<i>Fluksi nga aktivitetet e shfrytëzimit</i>						
Arkëtimet nga klientët	600	1.79	1,074	600	2.11	1,266
Paguar furnitorëve dhe punonjësve	(180)	1.79	(322.2)	(500)	2.11	(1,055)
MM të gjeneruara nga aktivitetet e shfrytëzimit	420		751.8	100		211
Tatim fitimi i paguar	(126)	2.05	(258.3)			
<i>MM neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</i>	294		493.5	100		211.0
<i>Flukset nga aktivitetet e investimit</i>						
Shuma paguar për blerjen e një AAM				(900)	1.9	(1,710)
<i>MM neto nga aktivitetet investuese</i>				(900)		(1,710)
<i>Flukse nga aktivitetet financuese</i>						
Emetim i aksioneve				1,000	2	2,000
<i>MM neto nga aktivitetet financuese</i>				1,000		2,000
Rritja neto (Rënia) në MM ose ekuivalentë të tyre	294		494	200		501
MM dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës	200	1.95	390			
Humbje të porealizuara nga ndryshimi i kursit të monedhave, në MM ose ekuivalentë të tyre	n/a		153.9	n/a		(111)
<i>MM dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës</i>	494	2.1	1,037.4	200	1.95	390

	Kapitali aksionar	Rezervat nga ndryshimet e kurseve	Fitimet e pashpërndara	Totali
	USD	USD	USD	USD
Gjendja më 1 janar 20X0	2,000			2,000
Të ardhurat gjithëpërfshirëse 20X0		(97)	620.3	523.3
<i>Gjendja më 31 dhjetor 20X0</i>	<i>2,000</i>	<i>(97)</i>	<i>620.3</i>	<i>2,523.3</i>
Të ardhurat gjithëpërfshirëse 20X1		265.7	413.5	679.2
<i>Gjendja më 31 dhjetor 20X1</i>	<i>2,000</i>	<i>168.7</i>	<i>1,033.8</i>	<i>3,202.5</i>

SHTOJCË 2 – Referuar nenit 14, pika 2

Supozohet se njësia ekonomike A ka një investim në pjesëmarrje në kapitalet e njësisë ekonomike B në masën 25%. Kapitalet e njësisë B janë në vlerën 20,000 euro. Pra, investimi fillestar në pjesëmarrje është 5,000 euro ($20,000 * 25\%$). Njësia ekonomike A e klasifikon këtë zë tek investimet në pjesëmarrje.

Pasqyrat individuale të njësive ekonomike A dhe B në datë 31 dhjetor 20X0

	Njësia ekonomike A	Njësia ekonomike B
	Euro	Euro
Aktive afatshkurtra	50,000	0
Investime financiare (tek B)	5,000	0
AAM	60,000	20,000
Totali i aktivit	115,000	20,000
Të pagueshme	75,000	0
Kapitali dhe rezervat	40,000	20,000
<i>Aksione</i>	<i>24,000</i>	<i>20,000</i>
<i>Rezerva</i>	<i>0</i>	<i>0</i>
<i>Fitimi i pashpërndarë</i>	<i>16,000</i>	<i>0</i>
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	115,000	20,000

Të dhënat fillestare për fitim/humbjen e njësive ekonomike A dhe B në fitin 20X1

	Njësia ekonomike A	Njësia ekonomike B
	Euro	Euro
Të ardhura nga shitja	100,000	40,000
Kosto e shitjeve	80,000	28,000
Të ardhura nga investimet në pjesëmarrje	3,000	0
Fitimi neto	23,000	12,000

Të dhënat fillestare për fitim/humbjen e njësive ekonomike A dhe B në fitin 20X2

	Njësia ekonomike A Euro	Njësia ekonomike B Euro
Të ardhura nga shitja	120,000	50,000
Kosto e shitjeve	100,000	30,000
Të ardhura nga investimet në pjesëmarrje	5,000	0
Fitimi neto	25,000	20,000

Viti 20X1 - Njësia ekonomike A

Në mbyllje të vitit 20X1 njësia ekonomike A rregullon vlerën e investimit financiar tek B me përqëndjen ndaj fitimit të njësisë ekonomike B (ky rregullim mund të bëhet duke i'u referuar pasqyrave të publikuara të njësisë ekonomike B, ose minutave të takimit të mbledhjes së aksionarëve të njësisë ekonomike B për miratimin e pasqyrave, apo mjeteve të tjera të komunikimit sipas marrëveshjes mes palëve A dhe B). Me supozimin se pasqyrat financiare të njësisë ekonomike B publikohen përpara publikimit të pasqyrave financiare të njësisë ekonomike A, kjo e fundit e bën veprimin rregullues në vitin që vjen por duke prekur pasqyrat e vitit 20X1.

- 1) Rregullimi i investimit në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike A me përqindjen ndaj fitimit të shpallur të njësisë ekonomike B

D Investimi financiar 3,000 (12,000 * 25%)

K Të ardhura nga investimet në pjesëmarrje 3,000

- 2) Gjatë vitit 20X1 njësia ekonomike A nuk arkëton dividendë nga investimi në njësinë ekonomike B, kështu që e ardhura e njohur për investimet në pjesëmarrje, do të paraqitet nga njësia ekonomike A si rezervë dhe nuk do të jetë e mundur të shpërndahet për aksionarët.

D Fitimi i pashpërndarë 3,000

K Rezerva 3,000

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për njësinë ekonomike A në dhjetor 20X1

Përshkrimi i zërave	Euro
Të ardhura nga shitjet	100,000
Kosto e shitjeve	80,000
Fitimi bruto	20,000
Të ardhura nga investimet në pjesëmarrje	3,000
Fitimi neto	23,000

Pasqyra e pozicionit financiar për njësinë ekonomike A në dhjetor 20X1

	Euro
Aktive afatshkurtra	70,000
Investime financiare (5,000 + 3,000)	8,000
AAM	60,000
Totali i aktivitet	138,000
Të pagueshme	75,000
Kapitali dhe rezerva	63,000
<i>Aksione</i>	<i>24,000</i>
<i>Rezerva</i>	<i>3,000</i>
<i>Fitimi i pashpërndarë</i> <i>(16,000 + 23,000 – 3,000)</i>	<i>36,000</i>
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	138,000

Kështu, fitimi i pashpërndarë i njësisë ekonomike A për vitin 20X1 konsiston në fitimet e pashpërndara të mbartura nga periudhat e mëparshme në vlerën 16,000 euro, shtuar me fitimin e vitit aktual 23,000 euro dhe pakësuar me shumën që shkon në rezerva prej 3,000 eur, përfaqësuar nga diferenca mes të ardhurave nga investimet në pjesëmarrje dhe dividendit të arkëtuar nga këto investime.

Viti 20X2 – Njësia ekonomike A

Supozojmë se në vitin 20X2, në muajin Korrik, njësia ekonomike B deklaroi dividendë në kuotën 60% të fitimit të deklaruar 20X1. Nga llogaritjet del që dividendë për t'u shpërndarë nga njësia ekonomike B do të jenë në vlerën 7,200 euro ($12,000 * 60\%$). Dividendi i deklaruar u pagua plotësisht nga B në vitin 20X2 dhe njësia ekonomike për dividendin e arkëtuar bën veprimin e mëposhtëm kontabël:

- 3) Njohja e dividendëve nga investimi në pjesëmarrje, deklaruar për vitin 20X1 në vlerën 1,800 euro ($7,200 * 25\%$) mbështetur në minutat e takimit të Asamblesë së ortakëve të njësisë ekonomike B

D Të tjera të arkëtueshme 1,800
K Investime financiare 1,800

- 4) Regjistrimi i dividendëve të arkëtuar

D Mjete monetar 1,800
K Të tjera të arkëtueshme 1,800

- 5) Pakësimi i rezervave në shumën e dividendit të arkëtuar

D Rezerva 1,800
K Fitimi i pashpërndarë 1,800

Më pas do të rregullohet vlera e investimit financiar mbështetur në fitimin e siguruar në vitin 20X2 nga njësia ekonomike B. Supozojmë të njëjtën situatë: njësia ekonomike B i publikon pasqyrat përpara se të publikohen pasqyrat financiare të njësisë ekonomike A, kështu që A i regjistron veprimet në lidhje me investimin në pjesëmarrje në pasqyrat 20X2.

- 6) Rregullohet vlera e investimit me përqindjen ndaj fitimit të njësisë ekonomike B në vitin 20X2 ($20,000 * 25\%$)

D Investimi financiar 5,000

K Të ardhura nga investimet në pjesëmarrje 5,000

- 7) Meqenëse në këtë moment dividendët nuk janë arkëtuar, kjo shumë duhet reflektuar në rezerva, tek pasqyra e pozicionit financiar

D Fitimi i pashpërndarë (20X2) 5,000

K Rezarva 5,000

Kështu, vlera e investimit në 31.12.20X2 do të jetë 11,200 euro ($5,000 + 3,000 - 1,800 + 5,000$) dhe rezerva do të jetë 6,200 euro ($3,000 - 1,800 + 5,000$).

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të njësisë ekonomike A në dhjetor 20X2

	Njësia ekonomike A Euro
Të ardhura nga shitja	120,000
Kosto e shitjeve	100,000
Fitimi bruto	20,000
Të ardhura nga investimet në pjesëmarrje	5,000
Fitimi neto	25,000

Pasqyra e pozicionit financiar të njësisë ekonomike A në dhjetor 20X2

	Euro
Aktive afatshkurtra	91,800
Investime financiare ($5,000 + 3,000$)	11,200
AAM	60,000
Totali i aktivitet	163,000

Të pagueshme	75,000
Kapitali dhe rezerva	88,000
<i>Aksione</i>	<i>24,000</i>
<i>Rezerva</i>	<i>6,200</i>
<i>Fitimi i pashpërndarë</i> <i>(36,000 + 25,000 + 1,800 – 5,000)</i>	<i>57,800</i>
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	163,000